

Bashkësia shqiptare,

Zelandë e Re:

Lajmi për vdekjen e Presidentit të Kosovës, dr Ibrahim Rugova është pritur me hidhërim të madh në mesin e shqiptarëve që jeton në Zelandë të Re. Shqiptarët u mbledhën në lokalet e klubit "Dardania" për të shprehur dhimbjen e respektin për njeriun që krejt jetën punoi për Kosovën dhe popullin e saj. Në fillim kryetari i Kryesisë së Lidhjes Qytetare të Shqiptarëve në Zelandë të Re Tahir Tahiri, njoftoi të tubuarit e shumë të lajmin e hidhur për vdekjen e Presidentit Ibrahim Rugova. Pastaj fjala iu dha Akademik Enver Gjerçekut, i cili foli për dr. Rugovën si

lider partiak e shtetëror, shkencëtar, intelektual e humanist të shquar, që do të mbetet në historinë e shqiptarëve për gjithmonë. Të tubuarit me këtë rast shkruan një telegram ngushëllimi familjes së dr. Rugovës, Presidencës, Qeverisë, Parlamentit të Kosovës, Kryesisë së LDK-s dhe qytetarëve të Kosovës ku shprehën dhembjen, pikëllimin... shprehen shpresën se në këto qaste vendimtare për Kosovën do të gjenden forca për ta qarë në vend amanetin e dr. Ibrahim Rugovës, pavarësinë e Kosovës.

Biografi e shkurtër e Presidentit Rugova:

Ibrahim Rugova u lind më 2 dhjetor 1944 në fshatin Cerrcë, komuna e Istogut, në Kosovë. Më 10 janar 1945, komunistët jugosllavë ia pushkatojnë babin e tij Ukë Rugova dhe gjyshin Rrustë Rugova, që kishte qenë luftëtar i njohur kundër çetave çetnike që po depërtonin gjatë Luftës së Dytë Botërore në krahinën e Rugovës. Ibrahim Rugova mbaroi shkollimin e mesëm në Pejë më 1967. Diplomoi në Degën e Albanologjisë të Fakultetit të Filozofisë të Universitetit të Prishtinës më 1971. Zoti Rugova qëndroi gjatë një viti akademik (1976-77) në Paris, në Ecole Pratique des Hautes Etudes, nën mbikëqyrjen e Prof. Roland Barthes-it, ku ndoqi interesimet e veta shkencore në studimin e letërsisë, me përqendrim në teorinë letrare. Ibrahim Rugova mori doktoratën në letërsinë në Universitetin e Prishtinës më 1984. Më 1996, Dr. Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe të Shkencave të Kosovës. Po në këtë vit ai u shpall doktor nderi I Universitetit të Parisit VIII në Paris. Autor i dhjetë librave (shih më poshtë), Dr. Ibrahim Rugova ishte në nismë redaktor në gazetën e studentëve "Bota e re" dhe në revistën shkencore "Dituria" (1971-72), që botoheshin në Prishtinë. Pastaj për afro dy dekada, Dr. Rugova punoi në Institutin Albanologjik të Prishtinës si hulumtues I letërsisë. Për një kohë ka qenë kryeredaktor I revistës "Gjurmime albanologjike", që e nxirrte ky Institut. Dr. Rugova është zgjedhur kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës më 1988, i cili u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare që po kundërshtonte sundimin komunist serb/jugosllav në Kosovë. Si intelektual me nam që i jepte zë kësaj lëvizjeje intelektuale e politike, Dr. Rugova u zgjodh më 23 dhjetor 1989 kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), partisë së parë politike në Kosovë që e sfidoi drejtpërdrejt regjimin komunist në fuqi. LDK-ja u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit, edhe pse në ndërkohë u shfaqën në skenë edhe parti e grupe të tjera. Nën udhëheqjen e Dr. Ibrahim Rugovës, LDK-ja, në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë dhe me Kuvendin e atëhershëm të Kosovës, përmbylli kornizën ligjore për institucionalizimin

e pavarësisë së Kosovës.

Deklarata e Pavarësisë (2 korrik 1990), shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës mbajtur në fund të shtatorit të vitit 1991, qenë prelud për zgjedhjet e para shumë partiake për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet presidenciale në Republikën e Kosovës më 24 maj 1992. Gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s në mars të vitit 1999, Rugova mbetet i ngujuar në shtëpinë e tij në Prishtinë. Ai gjatë kësaj kohe detyrohet të takohet dy here me Millosheviqin në Beograd dhe të kërkojë edhe ndërprerjen e bombardimeve të NATO-s. Ai dhe familja e tij, arrin të largohen nga Kosova dhe të strehohen në Itali, vetëm pas ndërhyrjes së komunitetit fetar Shan Exhidio, i cili mbante raporte miqësore me Millosheviqin. Në Kosovë Rugova kthehet menjëherë pas luftës.

Në vitin 2002 bëhet kryetar i Kosovës i njohur ndërkombëtarisht. Rugova e krijoi edhe qeverinë e parë me partinë e udhëheqësit politik të ish-UÇK-së, Hashim Thaçi. Presidenti Rugova dhe LDK-ja, arrijnë që të fitojnë edhe zgjedhjet e dyta të përgjithshme dhe Rugova në vitin 2004 rizgjidhet president edhe për katër vite të tjera. Ai arrin të jetë edhe dëshmitar kundër armikut të tij të vjetër Slobodan Millosheviqit në Gjykatën e Hagës për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi. Gjatë kësaj kohe të presidencës së tij, ka pasur edhe një tentim vrasje ndaj tij: në korrik të vitit 2005 shpërtheu një bombë në afërsi të makinës së tij, mirëpo ai shpëtoi i pa lënduar. Pak muaj më parë, Ibrahim Rugova krijoi edhe grupin negociator për zgjidhjen e statusit të Kosovës, dhe ai u vu në krye të këtij grupi. Në fund-gushtin e vitit 2005 mjekët zbuluan se presidenti Rugova vuante nga kanceri në mushkëri. Ai vdiq të shtunën në moshën 61 vjeçare në ora 11.38 minuta në rezidencën e tij në Prishtinë në praninë e familjes dhe mjekut personal. Është baba i tre fëmijëve, dy djemve dhe një vajze

Çmimet dhe titujt ndërkombëtarë:

- Më 1995, Dr. Rugovës iu dha Çmimi për paqe I Fondacionit Paul Litzer në Danimarkë. - Më 1996, Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Parisit VIII Sorbonë, Francë. - Më 1998, Rugova iu nda Çmimi Saharov i Parlamentit Evropian. - Në vitin 1999, Rugova mori Çmimin për paqe të qytetit Mynster (Münster), Gjermani, ndërsa u shpall qytetar nderi i qyteteve italiane: Venedikut, Milanos dhe Breshias (Brescia). - Në vitin 2000, Dr. Rugova mori Çmimin për paqe të Unionit Demokratik të Katalonisë "Manuel Carrasco I Formiguera", në Barcelonë, Spanjë. - Në vitin 2004, Fondacioni panevropian Coudenhove-Kalergi i ka ndarë Presidentit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova, Çmimin e Evropës për vitin 2004. - Në vitin 2004, Gjenerali Xheri Bek, komandant i Brigadës Multinacionale të KFOR-it Lindja, i cili ishte për një vizitë lamtumirës te Presidenti i Kosovës ditën e hënë më 16 shkurt 2004, ia dorëzoi Dr. Rugovës fletëlavdërimin e nënshkruar nga zëvendësguvernatorja e Pensilvanisë, znj. Kethrinë Bejkër Noll (Catherine Baker Knoll). "...Në emër të 12 milionë qytetarëve të Pensilvanisë, dua t'ju shpreh lëvdatë për arritjet tuaja të jashtëzakonshme dhe t'ju falënderoj për miqësinë tuaj ndaj Shteteve të Bashkuara." (znj. Kethrinë Bejkër Noll) - Në vitin 2004, Presidenti i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova, në një ceremoni solemne të

zhvilluar të hënën më 2 shkurt 2004, pasdite në qytetin e Belgjikës Atverpen (Anvers), është shpallur Senator Nderi I Evropës nga Senati i Evropës. Ky është grupacion I figurave më eminente të skenës politike evropiane nga i cili nderohen personalitete më në zë të botës së politikës, gazetarisë, të shkencave ekzakto apo humane të cilët ka dhënë kontributin e tyre për demokracinë paqen, zhvillimin apo stabilitetin në Evropë.

"Është shumë e vështirë që të luftosh për vetëvendosjen dhe vullnetin e lirë të një populi të vogël, kur kjo nuk korrespondon me dëshirën e popujve të mëdhenj. Rugova vazhdoi që të luftojë vetëm, ndonjëherë pa hasur në mirëkuptim për një ideal që do të mund t'i japë Evropës atë paqe për të cilën ne kemi nevojë. Është pikërisht kjo gjë që do ta nderojë sot me titullin Senator Evropian që të mos dekurajohet". (Z. Oto fon Habsburg) - Më 9 shtator 2004, Ibrahim Rugova u shpall Doktor Nderi (Honoris Causa) i Universitetit të Tiranës. - Më 20 nëntor 2005, Këshilli i Qytetit të Nju Jorkut e ka nderuar presidentin e Kosovës, Ibrahim Rugova, me një mirënjohje të veçantë për përkushtimin e tij në afirmimin e parimeve të demokracisë dhe për udhëheqjen e tij politike frymëzuese. - Më 21 janar 2006, pushon së rrahuri zemra e Presidentit të Parë të Kosovës, Ibrahim Rugova.

Ka thënë dr. Rugova:

"Kompromis për ne është pavarësia. Këtë e kam thënë një mijë herë dhe kjo do të jetë sepse siç e dini ne nuk kemi kërkuar bashkim me Shqipërinë, pasi që jemi të vetëdijshëm që një zgjidhje e tillë do të hapte probleme të tjera. - "Me shtimin e represionit serb, ne kemi zbuluar në vete burime të tjera durimi, organizimi, që me Lidhjen tone po provojmë t'i vëmë në veprim. Paradoksalisht, kujtoj se kemi arritur atë që nuk e kishim arritur gjatë kohë: një liri të brendshme. Po e paguajmë shumë shtrenjtë dhe është e pasigurt". - "Unë dua të mbaj pak më shumë shpresë dhe ta shtyj çështjen, në mënyrë që shqiptarët të rezistojnë, me këtë rrugë të jo dhunës që kemi zgjedhur hëpërhë, qoftë edhe nëse duhet që një ditë politika jonë të bëhet pak më agresive ndoshta".

"Praktika kundër dhunës në këtë situatë I përgjigjet në një farë mënyre karakterit tonë, një tradite të durimit dhe qëndrimit Me anën e kësaj rezistence aktive të bazuar mbi¼kundraall gjithë dominimeve jo

dhunën dhe solidaritetin, ne "jemi gjetur". Sot ia kemi dalë të prekim këtë pikë të shpirtit të popullit shqiptar". - "Unë kam kërkuar shpesh në fillim të këtij viti, deri në ditët e sotme, mbrojtjen ndërkombëtare për disa vjet, me qëllim që të qetësohet situata dhe të mëkëmben institucionet demokratike. - Pastaj, do të mund të flitnim për statusin e Kosovës. Mendoj se solucioni më i mirë transitor, apo provizor, për të penguar konfliktin apo konfrontimin, është kjo formë e protektoratit ndërkombëtar, ajo që amerikanët e quajnë trusteeship system. - Në planin e paqes që ua propozova Kombeve të Bashkuara, kërkova dërgimin e trupave të OKB-së apo të NATO-s, masa për të kontrolluar forcat ushtarake; njëkohësisht të njëjtat propozime ia përcolla edhe Konferencës së Gjenevës". - Kosova është e pavarur. Duhet njohja formale.